



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 5214 Prot

Elbasan më 15 /10/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHTATOR 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin SHTATOR 2025 gjithsej 87 familje me një fond gjithsej 252.000 lekë .
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Konfirmoi: D.Rroseni

Zv/kryetari

Armand Shehu





BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE
DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR

INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN
SHTATOR 2025

I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHTATOR 2025

Shtator 252 familje fondi 1.192.909

Gusht 245 familje fondi 1.170.927

Për muajin Gusht 2025 kemi 7 familje më shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi është 21.982 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Shpresa Koburja | (aplikon në sistem) |
| 2. Agim Muça | (del nepension) |
| 3. Vladimir Kordali | (del ne pension) |
| 4. Tazine Hoxha | (del ne pension) |
| 5. Agim Deliu | (aplikon në sistem) |
| 6. Zeqir Popa | (aplikon në sistem) |
| 7. Petrit Qoku | (aplikon në sistem) |
| 8. Sabrije Çoji | (aplikon në sistem) |
| 9. Mimosa Korra | (aplikon në sistem) |
| 10. Festim Çelanj | (aplikon në sistem) |
| 11. Ilmi Qoli | (aplikon në sistem) |
| 12. Taulant Kallo | (aplikon në sistem) |
| 13. Petrit Qoku | (aplikon në sistem) |
| 14. Mustafa Coh | (aplikon ne sistem) |

II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHTATOR 2025

Shtator	87 familje	fondi	252.000
Gusht	77 familje	fondi	237.000

Për muajin Gusht 2025 kemi 9 familje më shumë se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi i shpenzuar është 15.000 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

- | | |
|---------------------|-----------------------------|
| 1. Esmeralda Vllahu | (nuk paraqitet) |
| 2. Selim Hazma | (aplikon ne sistem) |
| 3. Gulid Lumani | (languar jashte Shqiperise) |
| 4. Kristaq Shqau | (aplikon ne sistem) |
| 5. Vasil Hasa | (nuk paraqitet) |
| 6. Vasil Çakalli | (aplikon ne sistem) |
| 7. Guxim Çarçiu | (nuk paraqitet) |

Konceptoi

Specialiste Ermira Dika

Përgjegjëse Sektori

Miranda Duka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr _____ Prot

Elbasan më ____/10/ 2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. ____ datë ____/10/ 2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin SHTATOR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/10/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin SHTATOR 2025 për 87 familje me një fond prej 252.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr.Prot. 5216

Elbasan më 15 /10/2025

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin SHTATOR 2025
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin SHTATOR 2025 ,
254 familje me një fond prej 1.192.909 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka
Pranoi: D.Shuli
Miratoi: D.Rroseni

ZV/ KRYETARI

ARMAND SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/10/ 2025

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/10/2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin SHTATOR 2025

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____10/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin SHTATOR 2025 për 254 familje me një fond prej **1.192.909** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4797 Prot.

Elbasan, më 24.09.2025.

RELACION

*“Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola”
(kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, Z.K. 8521, Akademisë së Futbollit
Elbasan nga Bashkia Elbasan”.*

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Prenave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, i ndryshuar, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, Z.K. 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan.

Akademia e Futbollit Elbasan i është drejtuar Bashkisë Elbasan me shkresën nr. 4730 Prot., datë 22.09.2025, kërkesë për marrjen në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, lagjja “Luigj Gurakuqi”, për t’i përdorur si ambjente për akomodimin e sportistëve të moshave dhe stafit shoqërues gjatë periudhave të stërvitjeve intensive, grumbullimeve, kampeve dhe aktiviteteve/turneve që organizohen në qytetin e Elbasanit. .

Për sa më sipër, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë me sipërfaqe 543 m² dhe kati i dytë me sipërfaqe 543 m²) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1 me sipërfaqe 263 m² ndodhur në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K 8521, për t’i përdorur si ambjente për akomodimin e sportistëve të moshave dhe stafit shoqërues gjatë periudhave të stërvitjeve intensive, grumbullimeve, kampeve dhe aktiviteteve/turneve që organizohen në qytetin e Elbasanit, për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data 01.10.2025 deri më 30.09.2030 (planimetria bashkëlidhur).

KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Klaudia Krasnika

Konceptoi: G. Kerri

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria P.A.P:


Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha

A. Suli

Y. Kasa

S.Mehmeti




PLANIMETRIA E KATIT PERDHE TE KONVIKTIT YMER TOLA
SIPERFAQJA E KATIT PERDHE QE JEPET ME QERA sip.=263m²m²
ZK 8521 PAS NR 7/93 SIP. TRUALL 1611m² nga kjo ND. 1436m².
SH 1:300

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE & STREHIMIT
Ing. Gjeodet GENTIANA KERRI
Dr. ARBA SULI

MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA




PLANIMETRIA E KATIT PERDHE TE KONVIKTIT YMER TOLA



SHPJEGUES

- PLANIMETRIA
- PJESA QE JEPET ME QERA

Data 22/09/2025



PLANIMETRIA E KONVIKTIT YMER TOLA
SIPERFAQJA QE JEPET ME QERA KATI I PARE DHE KATI I DYTE TEKNIK
ME Sip.=543m2 SECILI.
ZK 8521 PAS NR 7/93 SIP. TRUALL 1611m2 nga kjo ND. 1436m2.
SH 1:300

BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE & STREHIMIT


Ing. Gjeodet GENTIANA KERRI
Dr. ARBA SULI




MIRATOI
KRYETARI I BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

PLANIMETRIA E KONVIKTIT YMER TOLA

KATI I PARE, KONVIKTI DJEME



PLANIMETRIA E KATIT PARE DHE KATIT TE DYTE



SHPJEGUES

PLANIMETRIA
PJESA QE JEPET ME QERA
Data 22/09/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan, më ____ .10.2025.

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ Datë: ____ .10.2025.

Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, Z.K. 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan nga Bashkia Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar “Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë)” dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, Z.K. 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë me sipërfaqe 543 m² dhe kati i dytë me sipërfaqe 543 m²) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1 me sipërfaqe 263 m², ndodhur në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan, për t’i përdorur si ambjente për akomodimin e sportistëve të moshave dhe stafit shoqërues gjatë periudhave të stërvitjeve intensive, për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data 01.10.2025 deri më 30.09.2030 (planimetria bashkëlidhur).
2. Akademia e Futbollit Elbasani nuk ka të drejtë të ndryshojë destinacionin e objektit.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi: G. Kerri

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria P.A.P:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J.I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

G. Dyrmyshi

Y. Kasa

S. Mehmeti

A. Hoxha

K. Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më: _____.10.2025.

DRAFT- KONTRATË HUAPËRDORJE

Lidhur sot më datë _____.10.2025, midis palëve kontraktuese si më poshtë vijon:

Në cilësinë e “Huadhënësit”: Bashkia Elbasan përfaqësuar nga kryetari **Z. Gledian Llatja**.

Në cilësinë e “Huamarrësit”: “Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a, me NIPT M13113202A përfaqësuar nga Administratori **Z. Amarildo Sulejmani**.

I-OBJEKTI I KONTRATËS

Kjo kontratë ka si objekt dhënien dhënien në përdorim (pa kundërshtëpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë me sipërfaqe 543 m² dhe kati i dytë me sipërfaqe 543 m²) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1 me sipërfaqe 263 m² ndodhur në lagjen “Luigj Gurakuqi”, Z.K 8521, (planimetria bashkëlidhur), për t’i përdorur si ambjente për akomodimin e sportistëve të moshave dhe stafit shoqërues gjatë periudhave të stërvitjeve intensive, grumbullimeve, kampeve dhe aktiviteteve/turneve që organizohen në qytetin e Elbasanit.

II-BAZA LIGJORE

1. Ligji Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
3. V.K.M. Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëoze apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar;
4. Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. ____, datë _____.2025 “Mbi dhënien në përdorim (pa kundërshtëpërblim) të ambjenteve me emërtimin Konvikti “Ymer Tola” (kati i parë dhe kati i dytë) dhe ambjentet e ish Rajonit Nr. 1, Z.K. 8521, Akademisë së Futbollit Elbasan nga Bashkia Elbasan”.

III-TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. **“Huadhënësi”** ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e **“Huamarrësit”**.
2. **“Huadhënësi”** për nevoja të ngutshme sipas gjykimit të tij, ka të drejtë të pezullojë përkohësisht përdorimin e ambjentit nga ana e **“Huamarrësit”**, duke i dërguar në mënyrë të menjëhershme njoftim me shkrim.
3. **“Huamarrësit”** nuk i lejohet të bëjë asnjë adoptim të ambjenteve të marra në përdorim që do të konsistonte në ndërhyrje të strukturave ndërtimore të ambientit pa marrë miratimin nga ana **“Huadhënësit”** dhe nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë Bashkisë.
4. **“Huamarrësi”** është i detyruar të riparojë të gjitha dëmtimet e mundshme që mund t’i bëhen ambjenteve të marra në përdorim si pasojë e keqpërdorimit apo pakujdesisë së tij në të kundërt **“Huamarrësi”** është i detyruar të dëmshpërblejë Bashkinë në masën e dëmit të shkaktuar të vlerësuar sipas ekspertëve.
5. **“Huamarrësi”** ka të drejtë që sipas legjislacionit në fuqi të përdorë, të gëzojë pronën e marrë në përdorim dhe përmirësimet e bëra në të, për të gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.
6. **“Huamarrësi”** ka për detyrë që në raste të situatave të jashtëzakonshme që gjykohen si të tilla nga **“Huadhënësi”** të dorëzojë menjëherë dhe pa kushte ambjentin Bashkisë.
7. **“Huamarrësit”** nuk i lejohet që pronën e dhënë në përdorim t’a japë me qira ose t’ia kalojë kontratën një tjetri ose të ndryshojë destinacionin e saj.
8. Janë në ngarkim të **“Huamarrësit”** të gjitha shpenzimet për mirëmbajtjen e përditëshme të ambjenteve të marra në përdorim. **“Huamarrësi”** duhet të shlyejë të gjitha detyrimet ndaj subjekteve përkatës në lidhje me konsumin e energjisë elektrike, ujit, etj. Për këtë **“Huamarrësi”** do të instalojë matësat përkatës dhe do të kontaktojë me subjektet furnizues. Janë në ngarkim të **“Huamarrësit”** të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë në përdorim.

IV-KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë lidhet me afat 5 (pesë) vite, nga data 01.10.2025 deri më 30.09.2030.

Kësaj kontrate i bashkëngjitet proces-verbali i dorëzimit të ambjentit nga ana e Bashkisë Elbasan si **“Huadhënëse”** dhe **“Huamarrësit”** Akademia e Futbollit Elbasani, sh.a.

V-ZGJIDHJA E KONTRATËS

Bashkia ka të drejtën e zgjidhjes së menjëhershme të Kontratës, nëse konstaton se **“Huamarrësi”** nuk kujdeset për mirëmbajtjen e Ambjentit, apo nuk zbaton kushtet e kontratës.

VI-ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve gjatë regjimit të kontratës së huapërdorjes, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata kompetente.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale ku katër kopje i mban **“Huadhënësi”**, Bashkia (Arkivë, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit, Këshilli Bashkiak) dhe një kopje e merr **“Huamarrësi”**.

“Huamarrësi”
“Akademia e Futbollit Elbasani” sh.a
Administratori
Z. Amarildo Sulejmani

“Huadhënësi”
KRYETARI
Gledian Llatja
Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika

Konceptoi: G. Kerri
Drejtoria P.P.S:
Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha
G. Dyrmyshi
S.Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE STREHIMIT

Nr. 4800/Prot.

Elbasan, më 14.10.2025.

RELACION

“Mbi shfuqizimin e Vendimit nr.79 dt 30.07.2024 dhe kalimin në varësi e administrim të ambjenteve të stadiumit “Elbasan Arena” Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale (strukturë vartëse e Bashkisë Elbasan).

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, i ndryshuar; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan”, i ndryshuar, Drejtoria e Pronave Publike dhe Strehimit i relatton Këshillit Bashkiak të miratojë shfuqizimin e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.79 datë 31.07.2024 “ Mbi dhënien e të drejtës së shfrytëzimit (pa pagesë) të pasurive me emërtimin stadiumi “ Elbasan Arena” AF Elbasanit” dhe kalimin në varësi e administrim të Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale të ambjenteve të stadiumit “ Elbasan Arena”, pasi kjo agjenci disponon më shumë staf dhe mjete logjistike çka mundëson kryerjen në mënyrë efektive të shërbimeve të mirëmbajtjes së Stadiumit “Elbasan Arena”. Në sajë të burimeve ekzistuese dhe përvojës në fushën e mirëmbajtjes, agjencia zotëron kapacitetet e mjaftueshme njerëzore dhe teknike për të siguruar mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe funksionale të objektit në përputhje me standartet e nevojshme për ambjente sportive të këtij niveli.

Njëkohësisht, referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.79 dt 30.07.2024, e drejta e shfrytëzimit të stadiumit “ Elbasan Arena” nga AF.Elbasani, sipas pikës 2 është dhënë për 1 vit, afat i cili ka përfunduar me datë 31.08.2025.

KRYETARI
Gledian Llatja

Me Urdhër e Porosi
Zv/KRYETARI
Klaudia Krasnika



Konceptoi: G. Kerri

A. Pisha

Drejtoria P.P.S:

G. Dyrmyshi

Drejtoria P.Sh.M:

S.Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____. _____. 2025

Projekt – Vendim
Nr _____ Datë ____/____/2025

Për shfuqizimin e vendimit nr 79 datë 30.07.2024 të këshillit bashkiak dhe administrimin e stadiumit “Elbasan Arena” nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale

Këshilli bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga administrata e Bashkisë për administrimin e mëtejshëm të stadiumit “Elbasan Arena”, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, nenet, 8, 9, 10, 25, 54 të tij, ligjin 79/2027 “Për sportin” ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimin e Ministrit të Financave nr 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

Vendosi

- 1- Stadiumi “Elbasan Arena” dhe të gjithë ambjentet e tij ndihmëse, të administrohen nga Agjensia e Shërbimeve Publike Rurale.
- 2- Vendimi i këshillit bashkiak nr 79 datë 30.07.2024, shfuqizohet
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Kryetari
Lutfi Lala

D.P.P.S
D.B.F.
D.J.I.
D.P.SH.M

G. Dyrmyshi
A. Merkja
A. Hoxha
S. Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA PRONAVE PUBLIKE DHE STREHIMIT

Nr. 2062 Prot.

Elbasan, më 10 . 10 . 2025.

R E L A C I O N

“Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Z.K. 8521, Partisë Socialiste dega Elbasan nga Bashkia Elbasan”.

KËSHILLIT BASHKIAK

K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin 8580 datë 17.02.2000 “Për partitë politike”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; V.K.M nr. 337 datë 09.06.2021 “Transferimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, për Njësinë Administrative Elbasan,” Ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8521, dhe të pasurisë 15/43, me emërtimin “Ish-Drejtoria Arsimore Elbasan”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8524, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 416 datë 11.07.2007, të Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar me V.K.M nr. 460 datë 30.07.2021, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit i relatton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të punësimit, lagjja “Kongresi Elbasanit”, Partisë Socialiste dega Elbasan. Partia Socialiste e Shqipërisë dega Elbasan i është drejtuar Bashkisë Elbasan me shkresën nr. 4856 Prot., datë 29.09.2025, për marrjen në përdorim pa kundërshtpërblim (rinovim kontrate) të ambjentit ish- Zyrat e Shërbimit Kombëtar të punësimit, lagjja “Kongresi Elbasanit”, për t’a përdorur si zyra për kryerjen e aktiviteteve politike.

Për sa më sipër, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit i relatton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (pa kundërshtpërblim) të ambientit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të punësimit, ndërtesë (2 kat), me sipërfaqe kati përdhe 432.4 m² dhe kati i parë 352 m², me nr. pasurie 5/38, ndodhur në lagjen “Kongresi Elbasanit”, Z.K 8521, për t’u përdorur si zyra të Partisë Socialiste dega Elbasan, për periudhën 4 (katër) vjeçare nga data 01.09.2025 deri më 31.08.2029 (planimetri bashkëlidhur)

KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



Konceptoi: G. Kerri


A. Pisha

Drejtorja P.P.S:

G. Dyrmyshi

Drejtorja P.Sh.M:

S. Mehmeti



MIRATOHET
KRYETARI BASHKISE
GLEDIAN LLATJA

PLANIMETRIA E KATIT TE PERDHE

ZK 8521 PAS NR 5/38-N2

SIP. TRUALL 352m2 nga kjo ND. 352m2.

SH 1:100

Siperfaqja e katit perdhe sip = 432.4m²


BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE & STREHIMIT

Ing. Gjeodet GENTIANA KERRI


Dr. ARBA SULI

Data 22/09/2025



MIRATOHET

KRYETARI BASHKISE
GLEDIAN LLATJA



PLANIMETRIA E KATIT TE PARE

ZK 8521 PAS NR 5/38-N2
SIP. TRUALL 352m² nga kjo ND. 352m².
SH 1:100

Siperfaqja e katit pare sip = 352 m²

BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE & STREHIMIT

Ing. Gjeodet GENTIANA KERRI

Dr. ARBA SULI

Data 22/09/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. ____ Prot.

Elbasan, më _____.2025.

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ Datë: _____.2025.

“Mbi dhënien në përdorim, (rinovim kontrate) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Z.K. 8521, Partisë Socialiste dega Elbasan nga Bashkia Elbasan”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligjin 8580 datë 17.02.2000. “Për partitë politike”, i ndryshuar; ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; V.K.M nr. 337 datë 09.06.2021 “Transferimin në pronësi të Bashkisë Elbasan, për Njësine Administrative Elbasan,” Ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8521, dhe të pasurisë 15/43, me emërtimin “Ish-Drejtoria Arsimore Elbasan”, me vendndodhje në zonën kadastrale 8524, dhe për disa shtesa në vendimin nr. 416 datë 11.07.2007, të Këshillit të Ministrave”, i ndryshuar me V.K.M nr. 460 datë 30.07.2021, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____.2025 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit, “Mbi dhënien në përdorim, (rinovim kontrate) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Z.K. 8521, Partisë Socialiste dega Elbasan nga Bashkia Elbasan”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies në përdorim pa kundërshpërblim (rinovim kontrate) të ambjentit ish-Zyrat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ndërtesë (2 kat), me sipërfaqe kati përdhe 432.4 m² dhe kati i parë 352 m², me nr. pasurie 5/38, ndodhur në lagjen “Kongresi Elbasanit”, Z.K. 8521, për t’u përdorur si zyra të Partisë Socialiste dega Elbasan, për periudhën 4 (katër) vjeçare nga data 01.09.2025 deri më 31.08.2029 (planimetri bashkëlidhur).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI
Lutfi Lala

Konceptoi: G. Kerri
Drejtorja P.P.S:
Drejtorja P.Sh.M:
Drejtorja J.I:
Zv/Kryetar:

A. Pisha
G. Dyrmysh
S. Mehmeti
A. Hoxha
K. Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 5162 prot.

Elbasan, më: 14.10.2025

RELACION

“Për miratimin e vlerës së qirasë mesatare të banesave në tregun e lirë dhe vlerën maksimale të subvencionit të qirasë për vitin 2026”

KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 8 dhe neni 24, në ligjin nr.22/2018 “Për Strehim Social”, i ndryshuar, Kreu V “Subvencioni i qirasë”, neni 38, për përcaktimin e vlerës së subvencionit të qirasë në tregun e lirë, pika 1, VKM-së nr. 362, datë 29.05.2019 “Kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij. Me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim të cilat me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë në tregun e lirë, duhet të miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak vlera maksimale e subvencionit të qirasë sipas nenit 38, pika 1 e ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar. Për realizimin e testimit të tregut, nga informacioni i marrë nga agjensitë imobiliare të cilat kanë dhënë informacionin mbi çmimet e referencës të qirave në territorin e Bashkisë Elbasan, dhe në bazë të këtij informacioni kemi llogaritur vlerat mesatare të qirave.

Qiratë mesatare të apartamenteve në treg të lirë për efekt subvencionimit të qirasë janë:

- Garsionere 10,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 1+1 10,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 2+1 12,000 lekë/muaj
- Apartament të tipit 3+1 15,000 lekë/muaj



KRYETARI
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika

Konceptoi: A. Beqiri
Drejtorja P.P.S:
Drejtorja P.Sh.M:
Drejtorja J. I:
Drejtorja F.B.:

R. Gremi
G. Dyrmyshi
S. Mehmeti
A. Hoxha
A. Merkja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ prot.

Elbasan, më: ____ .10.2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Datë: ____ .10.2025.

